



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

Treguesit Statistikor të Tregut të Komunikimeve Elektronike

Tremujori IV 2024

INDEKSI I PËRMBAJTJES

I.	HYRJE	3
II.	TENDENCAT KRYESORE.....	4
III.	TREGUESIT E TREGUT TË SHËRBIMEVE NGA RRJETET CELULARE.....	6
IV.	TREGUESIT E TREGUT TË SHËRBIMEVE NGA RRJETET FIKSE	10

INDEKSI I TABELAVE

TABELA 3.1 : NUMRI I PAJTIMTARËVE/PËRDORUESVE CELULARË SIPAS KATEGORIVE	6
TABELA 3.2: NUMRI I PAJTIMTARËVE TË SHËRBIMEVE CELULARË (KARTA SIM) SIPAS OPERATORËVE.....	7
TABELA 3.3: NUMRI I PËRDORUESVE AKTIVË TË SHËRBIMEVE CELULARE SIPAS OPERATORËVE	7
TABELA 3.3/1: PËRQINDJA E PËRDORUESVE AKTIVË ME PARAPAGIM TË SHËRBIMEVE CELULARE SIPAS OPERATORËVE	7
TABELA 3.4: NUMRI I PËRDORUESVE AKTIVË TË TELEFONISË CELULARE SIPAS OPERATORËVE	8
TABELA 3.5: NUMRI I PËRDORUESVE TË AKSES BROADBAND NË RRJETET 3G/4G SIPAS OPERATORËVE.....	8
TABELA 3.6: VOLUMI TOTAL I THIRRJEVE, SMS-VE, TË DHËNA DHE PËRDORIMI MESATAR MUJOR.....	8
TABELA 3.7: STRUKTURA E THIRRJEVE DALËSE CELULARE TË ORIGJINUAR BRENDA VENDIT SIPA DESTINACIONIT...	9
TABELA 4.1 : NUMRI I LINJAVE TË PAJTIMTARËVE TË TELEFONISË FIKSE.....	10
TABELA 4.2 : NUMRI I PAJTIMTARËVE ME AKSES BROADBAND NGA RRJETET FIKSE.....	10
TABELA 4.3 : NUMRI I PAJTIMTARËVE QË KANË AKSES NË SHËRBIME TË INTEGRUARA	11

I. Hyrje

Bazuar në përcaktimet e Ligjit Nr. 54/2024, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë dhe Rregullores nr.12, datë 07.04.2010, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” e ndryshuar, AKEP mbledh të dhëna periodike statistikore nga sipërmarrësit ofrues të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në Shqipëri.

AKEP ka filluar të publikojë periodikisht të dhëna dhe tregues statistikore të tregut të komunikimeve elektronike prej muajit Prill 2009 në faqen web www.akep.al. Periodiciteti i publikimeve dhe treguesit e publikuar kanë evoluar nga raportime vjetore dhe gjashtëmujore në raportime vjetore dhe tremujore duke filluar nga Tremujori 4 2014.

Sipërmarrësit e rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike kanë detyrim ligjor të dërgojnë në AKEP, të raportojnë të dhëna periodike rreth aktivitetit të tyre sipas formularëve përkatës që janë pjesë e Rregullores Nr.12. Informacioni i kërkuar nga AKEP nëpërmjet formularëve të Rregullores shërben për përmbushjen e detyrave funksionale të AKEP, ndër të tjera edhe për publikimin e treguesve për publikun e gjerë nëpërmjet raporteve periodike që evidentojnë treguesit kryesorë të zhvillimit të tregut të komunikimeve elektronike.

AKEP publikon treguesit kryesorë të tregut të komunikimeve elektronike duke marrë në konsideratë si natyrën konfidenciale të një sërë treguesve të raportuar nga sipërmarrësit edhe interesat e publikut për të krijuar një treg të hapur dhe konkurrues. Për këtë arsye shumë tregues paraqiten të agreguar për tregun në tërësi dhe jo sipas operatorëve, ndërsa disa tregues paraqiten edhe sipas operatorëve.

AKEP mundohet që të dhënat e publikuara të jenë të plota dhe të sakta për të garantuar një pasqyrim të drejtë të situatës dhe tendencave të tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri. Megjithatë, në disa raste informacioni i mbledhur mund të mos jetë i plotë për shkak se jo të gjithë sipërmarrësit raportojnë në kohë dhe me cilësinë e duhur të dhënat e kërkuara.

AKEP për të rritur plotësinë dhe saktësinë e informacionit të mbledhur dhe të publikuar bashkëpunon me operatorët gjatë procesit të raportimit të të dhënave nëpërmjet komunikimit në modulën on-line, e-mail dhe telefon, si dhe përdor mekanizmat ligjorë të detyrimit të raportimit të të dhënave si inspektime në terren dhe/ose vendosjen e sanksioneve ligjore për mos-raportim të të dhënave.

Për të rritur cilësinë e informacionit të publikuar si dhe krahasueshmërinë me periudhat e mëparshme, AKEP në disa raste përfshin vlerësime të numrit të pajtimtarëve për operatorët (kryesisht operatorë të vegjël të rrjeteve fikse) që nuk kanë raportuar në periudhën përkatëse duke përdorur numrin e pajtimtarëve të raportuar në periudhat e mëparshme të këtyre operatorëve. Gjithashtu në disa raste AKEP mund të publikojë rishikim të treguesve të publikuar për periudhat e mëparshme për shkak të ndryshimeve të vlerësimeve dhe/ose metodologjisë së përdorur nga AKEP dhe/ose raportimeve të operatorëve. Të tilla raste evidentohen nëpërmjet shënimeve përkatëse të AKEP në publikimin më të fundit të të dhënave/informacionit të tregut.

Të dhënat dhe treguesit e publikuar në këtë raport janë për pesë tremujorët e fundit, si dhe të dhëna vjetore për vitin para-ardhës. Për periudhat më të hershme lexuesi mund t'i referohet publikimeve të mëparshme të AKEP. Norma e ndryshimit të një treguesi me tremujorin para-ardhës paraqitet si **‘Ndryshimi Tremujor’**, ndërsa norma e ndryshimit në terma vjetorë (me të njëjtin tremujor në vitin para-ardhës) paraqitet si **‘Ndryshimi v-m-v’**.

Për shkak të rrumbullakimeve të vlerave në disa raste mund të ekzistojë një mospërputhje jomateriale ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur nëpër tabela për tregues të caktuar.

Në Tremujorin e katërt 2024 kanë raportuar rreth 197 sipërmarrës të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, ndërsa për Tremujorin e tretë 2024 kanë raportuar 195 sipërmarrës. AKEP dëshiron të falenderojë operatorët që kanë depozituar të dhëna për këtë raport dhe shpreson në bashkëpunimin e vazhdueshëm me të gjithë operatorët për procesin e mbledhjes dhe publikimit të të dhënave statistikore të komunikimeve elektronike në të ardhmen.

AKEP mirëpret sugjerime për të përmirësuar procesin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave statistikore si dhe të publikimeve të AKEP, me qëllim plotësimin e interesit publik për të krijuar një treg të hapur dhe konkurues të komunikimeve elektronike në Shqipëri, duke ruajtur njëkohësisht konfidencialitetin e të dhënave të publikuar nga AKEP për të shmatur përdorimin e tyre në mënyrë antikonkurruese dhe me praktika tregtare jo të ndershme nga konkurrentët në treg.

Dokumenti në vijim përmban përshkrim të nivelit të treguesve kryesorë në Tremujorin IV 2024 (T4 2024) dhe krahasime me periudhat e mëparshme, dhe më pas paraqiten të dhënat statistikore në formë tabelare për shërbimet nga rrjetet celulare dhe nga rrjetet fikse, të shoqëruara dhe me disa shënime për përshkrimin e treguesve dhe mënyrën e matjes së tyre.

II. Tendencat kryesore

- Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare sipas kartave SIM në fund të T4 2024 ishte rreth 3,399,173 që përbën një rënie me 10% në krahasim me tremujorin e mëparshëm, dhe një rënie me 12% në krahasim me T4 2023;
- Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare gjatë T4 2024 arriti në rreth 2.5 milionë që përbën një rënie me rreth 11.2% me T3 2024 dhe rënie me rreth 4.6% me T4 2023;
- Numri i përdoruesve aktivë të aksesit broadband në Internet nga rrjetet celulare në T4 2024 ishte rreth 2.1 milionë që përbën një rënie rreth 12% me tremujorin e mëparshëm, dhe një rritje me 0.4% në krahasim me Tremujorin e katërt 2023.
- Totali thirrjeve dalëse të gjeneruara nga pajtimtarët celularë në Shqipëri në T4 2024 ishte rreth 1 miliardë minuta, me një rritje prej 1.2% në krahasim me tremujorin paraardhës dhe me një rritje prej 0.5% me T4 2023.
 - o Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (off-net) pësoi rritje me 5.9% në krahasim me T3 2024 dhe rritje me 3.5% në krahasim me një vit më parë në T4 2023;
 - o Sasia e thirrjeve on-net pësoi rënie me 1.2% në krahasim me T3 2024 dhe pësoi një rënie me 0.8% në krahasim me T4 2023.
 - o Proporcioni i thirrjeve on-net/off-net në T4 2024 ishte 60%/39%, kundrejt 61%/38% në T4 2023.
- Numri i mesazheve SMS të dërguara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare në T4 2024 ishte rreth 97 milion që përbën një rritje me 2.4% krahasuar me T3 2024 dhe një rënie me 2.6% me T4 2023;
- Sasia e trafikut data (Internet) në rrjetet celulare gjatë T4 2024 ishte rreth 56 Milion GByte. Një përdorues aktiv i aksesit broadband celular ka përdorur mesatarisht rreth 8.94 GB Internet në muaj në T4 2024, që përbën një rritje me 4.1% në krahasim me T3 2024 dhe një rritje me 0.9% krahasuar me T4 2023.
- Konsumi mesatar mujor për përdorues aktiv i shërbimeve celulare gjatë T4 2024 ishte: 145 minuta dalëse, 13 SMS dhe 8.94 GB Internet. Krahasuar me T3 2024, konsumi mesatar i thirrjeve pati një rritje me 14%, konsumi mesatar i SMS-ve pati një rritje me 15.4% dhe konsumi mesatar i internetit pësoi rritje me 4.1%.

Shërbimet nga rrjetet fikse

1. Numri i pajtimtarëve të linjave të telefonisë fikse në fund të tremujorit të katërt 2024 është raportuar rreth 165 mijë, me një rënie me 1.1% krahasuar me T3 2024 dhe me një rënie me 4.5% në krahasim me T4 2023.
2. Numri i pajtimtarëve me akses Broadband në internet nga rrjete fikse në T4 2024 arriti në rreth 687 mijë, që përbën një rritje me 3.6% në krahasim me tremujorin e mëparshëm dhe një rritje me rreth 8.6% në krahasim me të njëtin tremujor në vitin 2023.
3. Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni/Internet/TV) në fund të 3 muajorit të katërt 2024 arriti në rreth 300 mijë, një rritje kjo me 0.1% në krahasim me T3 2024 dhe rritje me 1.6% krahasuar me T4 2023.
4. Numri i pajtimtarëve me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV) përbën 23.2% të totalit të pajtimtarëve me paketa të integruara ndërsa 29.9% janë me paketa “Internet dhe Telefoni” dhe 46.9% me paketa “Internet dhe TV”.
5. 44% e pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse në fund të T4 2024 ishin pajtimtarë me paketa të integruara (Telefoni/Internet/TV), ku 10% janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

III. Treguesit e tregut të shërbimeve nga rrjetet celulare

Tabela 3.1 : Numri i pajtimtarëve/përdoruesve celularë sipas kategorive

	Numri i pajtimtarëve shërbime celulare	Përdorues aktivë shërbime celulare	Përdorues aktivë Telefoni Celulare	Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim	Përdorues aktivë me akses broadband celular	Përdorues me akses broadband telefoni celulare	Përdorues me akses broadband me karta të dedikuara
2022	3,771,419	2,782,226	2,755,305	67.8%	2,140,180	2,113,259	26,921
2023 T4	3,863,435	2,614,764	2,591,468	61.9%	2,082,525	2,059,229	23,296
2024 T1	3,712,327	2,471,406	2,460,162	60.3%	2,010,577	1,999,333	11,244
2024 T2	3,642,710	2,517,606	2,502,560	59.8%	2,062,969	2,047,923	15,046
2024 T3	3,775,364	2,806,335	2,785,132	63.0%	2,376,638	2,355,435	21,203
2024 T4	3,399,173	2,488,380	2,471,855	57.5%	2,091,266	2,074,741	16,525
Ndryshimi tremujor	-10.0%	-11.3%	-11.2%	-8.7%	-12.0%	-11.9%	-22.1%
Ndryshim v-m-v	-12.0%	-4.8%	-4.6%	-7.1%	0.4%	0.8%	-29.1%

Shënime:

Treguesi	Referenca ne Formulare/Menyrja e llogaritjes	Pershkrim/Sqarim
Numri i pajtimtarëve shërbime celulare (karta SIM)	D.10	Numri total i kartave SIM me parapagim dhe pas-pagim që janë aktivë në rrjetin celular në fund të periudhës së raportimit, pavarësisht nëse kanë kryer komunikim apo jo gjatë periudhës së raportimit. Treguesi përfshin të gjitha kartat SIM që përdoren për shërbime zanore dhe të dhenash, të instaluar në aparate celulare, modem, USB apo pajisje të tjera. Nuk përfshihen kartat M2M.
Përdorues aktive Shërbime Celulare	D.7	Numri total i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare në fund të periudhës së raportimit. Përfshihen përdoruesit me parapagim aktivë (komunikim në 3 muajt e fundit) dhe përdoruesit me paspagim (pavarësisht komunikimit ose jo në 3 muajt e fundit). Në këtë zë përfshihen përdoruesit e shërbimeve celulare me karta SIM dhe karta të dedikuara të dhenash (Data Card).
Përdorues aktive Telefoni Celulare	D.7-D.10.2	Numri total i përdoruesve aktivë të shërbimeve telefonike celulare në fund të periudhës së raportimit. Përfshihen përdoruesit me parapagim aktivë (komunikim në 3 muajt e fundit) dhe përdoruesit me paspagim (pavarësisht komunikimit ose jo në 3 muajt e fundit). Në këtë zë përfshihen përdoruesit e shërbimeve celulare me karta SIM telefonike. Nuk përfshihen Data Card.
Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim	D.7.1/D.7	Numri i përdoruesve aktivë (përdorim në tre muajt e fundit) që përdorin karta rimbushëse për përdorimin e shërbimit celular pjestuar me numrin total të përdoruesve aktivë (D.7.1/D.7).
Përdorues aktive të Akses Broadband Celular	D.10	Numri i pajtimtarëve në rrjetet celulare që kanë përdorur aksesin në Internet me shpejtësi broadband mbi 256 kbps (3G/4G ose më të avancuar) të paktën një herë gjatë periudhës së raportimit. Ky tregues ka kategorinë e përdorimit sipas aparatit telefonik celular, tableta etj me karta SIM (zanore dhe të dhëna) dhe nëpërmjet aksesit me karta SIM të dedikuara për të dhëna (USB, dongles etj).
Përdorues akses broadband celular dhe telefoni celulare	D.10.1	Numri i pajtimtarëve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin në Internet në rrjet 3G/4G ose më të avancuar nëpërmjet kartave SIM të telefonit celular.
Përdorues akses broadband me karta	D.10.2	Numri i pajtimtarëve të rrjetit që kanë përdorur aksesin në internet, në rrjet 3G/4G ose më të avancuar, nëpërmjet kartave të dedikuara për të dhëna (DATA CARD të dedikuara)

te dedikuara (Data Card)		
--------------------------	--	--

Tabela 3.2: Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare (karta SIM) sipas operatorëve

Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare (karta SIM) sipas operatorëve	Total	One Albania	Vodafone Albania ¹	Albtelecom
2022	3,771,419	1,431,456	1,859,779	480,184
2023 T4	3,863,435	2,029,588	1,833,847	
2024 T1	3,712,327	1,958,426	1,753,901	
2024 T2	3,642,710	1,866,166	1,776,544	
2024 T3	3,775,364	1,857,314	1,918,050	
2024 T4	3,399,173	1,715,581	1,683,592	
Ndryshimi tremujor	-10.0%	-7.6%	-12.2%	
Ndryshim v-m-v	-12.0%	-15.5%	-8.2%	

Tabela 3.3: Numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare sipas operatorëve

Numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare sipas operatorëve	Total	One Albania	Vodafone Albania ²	Albtelecom
2022	2,782,226	1,113,381	1,311,256	357,589
2023 T4	2,614,764	1,292,139	1,322,625	
2024 T1	2,471,406	1,222,098	1,249,308	
2024 T2	2,517,606	1,245,917	1,271,689	
2024 T3	2,806,335	1,336,606	1,469,729	
2024 T4	2,488,380	1,229,342	1,259,038	
Ndryshimi tremujor	-11.3%	-8.0%	-14.3%	
Ndryshim v-m-v	-4.8%	-4.9%	-4.8%	

TABELA 3.3/1: Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim të shërbimeve celulare sipas operatorëve

Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim sipas operatorëve	Total	One Albania	Vodafone Albania	Albtelecom
2022	67.888	74.109	62.068	69.864
2023 T4	61.893	66.506	57.387	
2024 T1	60.293	63.105	57.543	
2024 T2	59.757	61.841	57.714	
2024 T3	62.987	63.300	62.684	
2024 T4	57.534	59.807	55.316	
Ndryshimi tremujor	-5.453	-3.493	-7.368	
Ndryshim v-m-v	-4.359	-6.699	-2.071	

¹ Saktësuar vlerat për numrin e pajtimtarëve të shërbimeve celulare (karta SIM) nga Vodafone Albania sipas email-it të datës 31.01.2025 për periudhën T1-T4 2024, duke përjashtuar kartat SIM të përdorura për M2M.

² Saktësuar vlerat për numrin e përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare nga Vodafone Albania sipas email-it të datës 31.01.2025 për periudhën T1-T4 2024, duke përjashtuar kartat SIM të përdorura për M2M.

Tabela 3.4: Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare sipas operatorëve

Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare sipas operatorëve	Total	One Albania	Vodafone Albania	Albtelecom
2022	2,755,305	1,099,314	1,303,729	352,262
2023 T4	2,591,468	1,292,091	1,299,377	
2024 T1	2,460,162	1,222,051	1,238,111	
2024 T2	2,502,560	1,245,868	1,256,692	
2024 T3	2,785,132	1,336,565	1,448,567	
2024 T4	2,471,855	1,229,308	1,242,547	
Ndryshimi tremujor	-11.2%	-8.0%	-14.2%	
Ndryshim v-m-v	-4.6%	-4.9%	-4.4%	

Tabela 3.5: Numri i përdoruesve të akses broadband në rrjetet 3G/4G sipas operatorëve

Numri përdoruesve të akses broadband në rrjetet 3G/4G sipas operatorëve	Total	One Albania	Vodafone Albania ³	Albtelecom
2022	2,140,180	836,931	1,033,888	269,361
2023 T4	2,082,525	916,755	1,165,770	
2024 T1	2,010,577	863,449	1,147,128	
2024 T2	2,062,969	866,526	1,196,443	
2024 T3	2,376,638	967,613	1,409,025	
2024 T4	2,091,266	893,505	1,197,761	
Ndryshimi tremujor	-12.0%	-7.7%	-15.0%	
Ndryshim v-m-v	0.4%	-2.5%	2.7%	

Tabela 3.6: Volumi total i thirrjeve, SMS-ve, të dhëna dhe përdorimi mesatar mujor

	Totali i thirrjeve telefonike dalese	SMS të dërguara	Trafiku të dhëna (Gbyte)	Minuta në muaj për përdorues	SMS në muaj për përdorues	GB në muaj për përdorues
2022	5,048,711,750	553,607,871	184,480,857	154	17	7.30
2023 T4	1,068,734,213	100,122,826	55,389,762	137	13	8.87
2024 T1	1,007,299,439	92,233,261	51,304,241	136	12	8.51
2024 T2	969,871,207	99,790,185	54,751,559	129	13	8.85
2024 T3	1,061,602,707	95,204,619	61,268,214	127	11	8.59
2024 T4	1,074,246,507	97,491,535	56,107,821	145	13	8.94
Ndryshimi tremujor	1.2%	2.4%	-8.4%	14.0%	15.4%	4.1%
Ndryshim v-m-v	0.5%	-2.6%	1.3%	5.4%	2.1%	0.9%

³ Saktësuar vlerat për numrin e përdoruesve të akses broadband në rrjetet 3G/4G nga Vodafone Albania sipas email-it të datës 31.01.2025 për periudhën T1-T4 2024, duke përfshirë kartat SIM të përdorura për M2M.

Shënime:

Treguesi	Referenca në Formulare/Mënyra e llogaritjes	Përshkrim/Sqarim
Thirrje telefonike dalëse	D.11	Thirrje telefonike dalëse të kryera nga pajtimtarët e rrjeteve celulare gjatë periudhës së raportimit. Trafiku i përfshirë në pagesa fikse llogarit minutat e kryera (reale) dhe jo vlerat nominale të ofertave/shportave. Ky tregues nuk përfshin: - Trafikun e pajtimtrëve të rrjeteve celulare Shqiptare gjatë kohës që ata janë në roaming ndërkombëtar. - Trafikun e pajtimtarëve të rrjeteve të huaja gjatë kohës që ata janë në roaming në rrjetet celulare Shqiptare.
SMS të dërguara	D.13	Numri total i SMS-ve të dërguara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare drejt të gjitha destinacioneve, përfshirë SMS ndërkombëtare
Trafiku të dhëna (GByte)	D.14	I referohet sasisë së trafikut broadband të origjinuar brenda Shqipërisë nga rrjetet celulare 3G/4G ose me të avancuara. Trafiku përfshin shkarkimet dhe ngarkimet (doëload dhe upload) i matur në pikat e aksesit të përdoruesit fundor. Nuk përfshihet trafiku me shumicë dhe 'walled garden'.
Minuta në muaj për përdorues	D.11/(D.7-D.10.2)/3	Numri i minutave të thirrjeve dalëse që një përdorues aktiv i shërbimeve telefonike celulare ka gjeneruar mesatarisht në një muaj. Llogaritet si raporti i trafikut total dalës (D7) me numrin e përdoruesve aktive të telefonisë celulare (D.7-D.10.2) dhe rezultati pjestohet me 3. Në treguesit në bazë vjetore përdoret numri mesatar i përdoruesve aktivë në fillim dhe në fund të periudhës.
GB në muaj për përdorues	D.14/D.10/3	Sasia GB e trafikut të Internetit që një përdorues aktiv i shërbimeve akses broadband celular ka përdorur mesatarisht në një muaj. Llogaritet si raporti i trafikut total të të dhënave (D14) me numrin e përdoruesve aktive të aksesit broadband celular (D.10) dhe rezultati pjestohet me 3. Në treguesit në bazë vjetore përdoret numri mesatar i përdoruesve aktivë në fillim dhe në fund të periudhës.

Tabela 3.7: Struktura e thirrjeve dalëse celulare të origjinuar brenda vendit sipa destinacionit

Struktura e thirrjeve dalëse celulare	Total	On-net	Off-net	Fiks kombëtar	Ndërkombëtare	Të tjera
2022	5,048,711,750	2,838,967,001	2,124,892,426	42,858,747	36,960,853	5,032,723
2023 T4	1,068,734,213	647,327,219	404,033,680	8,543,177	7,314,366	1,515,771
2024 T1	1,007,299,439	614,202,055	377,505,132	8,012,630	6,312,557	1,267,065
2024 T2	969,871,207	595,442,071	357,937,135	7,965,974	7,281,350	1,244,677
2024 T3	1,061,602,707	650,035,435	394,647,594	7,141,613	8,459,776	1,318,289
2024 T4	1,074,246,507	642,416,260	418,110,410	6,767,072	6,055,005	897,760
Ndryshimi tremujor	1.2%	-1.2%	5.9%	-5.2%	-28.4%	-31.9%
Ndryshim v-m-v	0.5%	-0.8%	3.5%	-20.8%	-17.2%	-40.8%

IV. Treguesit e tregut të shërbimeve nga rrjetet fikse

Tabela 4.1 : Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse

Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse	Totali	One Albania	ASC	Vodafone Albania	Abissnet	Nisatel	OA të tjerë	Pjese tregu One Albania
2022	177,246	143,150	11,804	7,726	4,231	4,121	6,214	80.8%
2023 T4	173,135	139,763	11,777	8,742	4,216	3,320	5,317	80.7%
2024 T1	171,069	138,371	11,811	8,636	4,259	3,456	4,536	80.9%
2024 T2	167,617	136,339	11,808	7,217	4,292	3,456	4,505	81.3%
2024 T3	167,087	135,818	11,795	7,205	4,337	3,456	4,476	81.3%
2024 T4	165,290	134,176	11,809	7,203	4,336	3,456	4,310	81.2%
Ndryshimi tremujor	-1.1%	-1.2%	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%	-3.7%	-0.1%
Ndryshim v-m-v	-4.5%	-4.0%	0.3%	-17.6%	2.8%	4.1%	-18.9%	0.6%

Tabela 4.2 : Numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjetet fikse⁴

Numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse	Totali	One Albania	Vodafone Albania	ASC	Abissnet	Digicom	Nisatel	I.B.C	Fastnet Albania	OA të tjerë
2022	585,285	113,197	126,115	60,282	43,175	27,097	22,386	9,410	9,050	174,573
2023 T4	632,450	139,318	127,733	61,332	43,284	31,987	24,480	11,550	12,000	180,766
2024 T1	636,533	144,514	127,590	60,839	43,777	33,261	25,360	11,640	12,000	177,552
2024 T2	646,545	149,875	129,372	60,678	44,008	33,907	26,880	11,680	11,920	178,225
2024 T3	663,231	154,826	130,833	61,025	44,762	34,179	27,780	13,112	11,900	184,814
2024 T4	686,806	152,107	144,494	61,579	44,960	34,715	28,529	13,100	11,800	195,522
Ndryshimi tremujor	3.6%	-1.8%	10.4%	0.9%	0.4%	1.6%	2.7%	-0.1%	-0.8%	5.8%
Ndryshim v-m-v	8.6%	9.2%	13.1%	0.4%	3.9%	8.5%	16.5%	13.4%	-1.7%	8.2%

⁴ Në këtë tabelë janë paraqitur operatorët me mbi 8,000 pajtimtar me akses broadband nga rrjetet fikse.

Tabela 4.3 : Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara

Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)	Totali	Telefoni fikse dhe Internet	Telefoni fikse, Internet dhe TV	Internet dhe TV
2022	312,674	89,904	72,255	150,515
2023 T4	295,296	89,141	69,484	136,671
2024 T1	293,902	89,115	69,574	135,213
2024 T2	296,308	88,594	69,430	138,284
2024 T3	299,669	89,033	69,988	140,648
2024 T4	299,923	89,595	69,575	140,753
Ndryshimi tremujor	0.1%	0.6%	-0.6%	0.1%
Ndryshim v-m-v	1.6%	0.5%	0.1%	3.0%

Shënime:

Treguesi	Referenca në Formulare/Menyra e llogaritjes	Përshkrim/Sqarim
Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse	A.1	Ky tregues i referohet numrit total të linjave telefonike që pajtimtarët e rrjetit fikse përdorin për shërbim telefonik fikse dhe që plotësojnë dy kushte: 1) pajtimtarit i është alokuar një numër fikse në rrjetin e operatorit (përfshirë numrat e marrë nga operatorët e tjerë me portim), dhe 2) numri fikse i alokuar është në përdorim në fund të periudhës së raportimit, pavarësisht nëse është kryer apo jo thirje (dalëse apo hyrëse) gjatë periudhës nga pajtimtari. Pra ky tregues është sasia totale e numrave fikse të alokuar dhe që janë ende në përdorim nga pajtimtarët në fund të periudhës së raportimit. Këtu përfshihen edhe pajtimtarët që kanë të përfshirë shërbimin e telefonisë fikse si pjesë e paketave të integruara së bashku me shërbime të tjera si Internet, TV etj.
Numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjetet fikse	B.1	Përfshin numrin total të pajtimtareve me akses broadband fikse me shpejtësi download 256 kbit/s ose më të madhe. Ky tregues përfshin aksesin në internet me DSL, modem kabllor, fibër në shtëpi/ndërtese dhe gjithë llojet e tjera të aksesit broadband me rrjet fikse. Nuk përfshihet aksesit broadband me rrjet celular. Totali i pajtimtarëve llogaritet pavarësisht nga metoda e pagesës. Përfshin WIMAX fikse dhe çdo teknologji tjetër wireless fikse. Ky tregues i referohet numrit total të abonentëve aktive të internetit që përdorin rrjetin fikse. Qëllimi i këtij treguesi është abonenti aktiv, pra nëse atyre nuk ju gjenerohet një faturë mujore, vetëm ata abonentë që kanë përdorur internetin apo janë lidhur me Internet të paktën një herë gjatë 3 muajve të fundit duhet të numërohen. Nga ana tjetër, të gjithë pajtimtarëve që ju gjenerohet një faturë mujore duhet të numërohen si aktivë. Përfshin pajtimtarët që përdorin aksesin broadband për përdorim familjar dhe për biznes.
Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)	B.7	Numri total i pajtimtarëve që kanë paketa të përbashkëta (të integruar-bundles) sipas kombinimeve të mëposhtme. Paketa të integruara konsiderohen kur paguajnë një tarifë fikse që përfshin të paktën 2 shërbime: Telefoni, Internet apo TV.

Telefoni fikse dhe Internet	B.7.1	Numri i pajtimtarëve të rrjetit fiks që kanë paketë të përbashkët (dyfishe) telefoni dhe internet (pakete dyfishe), duke paguar një tarifë që përfshin dhe pajtimin mujor për telefoni dhe për akses në Internet broadband. Nuk përfshihen pajtimtarët që përdorin telefoni dhe Internet por që kanë tarifa të vecanta mujore për dy shërbimet. Paguesa fikse mund të përfshijë ose jo minuta thirrje (falas) dhe Interneti mund të jetë me limit ose pa limit.
Telefoni fikse, Internet dhe TV	B.7.2	Numri i pajtimtarëve të rrjetit fiks që kanë paketë të përbashkët (trefishe) telefoni, Internet dhe TV (IPTCV ose TV kabllor), duke paguar një tarifë që përfshin pajtimin mujor për telefoni, akses në Internet broadband dhe kanalet TV. Nuk përfshihen pajtimtarët që përdorin tre shërbimet por që kanë tarifa të vecanta mujore për tre shërbimet. Paguesa fikse mund të përfshijë ose jo minuta thirrje (falas) dhe Interneti mund të jetë me limit ose pa limit, si dhe kur ka pagesë ekstra për kanale TV shtesë mbi kanalet bazë TV.
Internet dhe TV	B.7.3	Pajtimtarë të rrjeteve fikse që kanë vetëm Internet dhe TV, pra jo telefoni fikse.